

**Organizata Joqeveritare
DokuFest**

Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare individuale
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2025

PËRMBAJTJA**FAQE**

RAPORTI I AUDITORIT

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

5

PASQYRA E TË ARDHURAVE

6

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET

7

PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË

8

SHËNIMET E PASQYRAVE FINACIARE

11-22

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Menaxhmentin dhe Bordin Drejtues të OJQ “DokuFest”

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të OJQ “DokuFest”, të cilat përfshijnë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2025, si dhe Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, Pasqyrën e ndryshimeve në fondet neto dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar në atë datë, si dhe një përmbledhje të politikave kontabël dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të OJQ “DokuFest” më 31 Dhjetor 2025, si dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar, në përputhje me **kornizën e raportimit financiar të aplikueshme për organizatat joqeveritare në Kosovë**, përfshirë kërkesat e Zyrës për OJQ.

Baza për Opinion

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin “Përgjegjësitë e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare” të raportit tonë.

Ne jemi të pavarur nga organizata në përputhje me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të atyre që janë të ngarkuar me qeverisje

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me kornizën e raportimit financiar të aplikueshme për OJQ-të në Kosovë, si dhe për kontrollet e brendshme që menaxhmenti i konsideron të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës për të vazhduar në vijimësi, duke shpalosur, kur është e nevojshme, çështjet që lidhen me vazhdueshmërinë dhe duke përdorur parimin e vazhdueshmërisë, përveç nëse

menaxhmenti synon të likujdijë organizatën ose të ndërpresë aktivitetin, ose nuk ka alternative tjetër reale.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të organizatës.

Përgjegjësitë e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë të lira nga gabimet materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk është garanci që një auditim i kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) gjithmonë do të zbulojë një gabim material kur ai ekziston. Gabimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, mund të pritet në mënyrë të arsyeshme që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të pasqyrave financiare.


Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit ose gabimit;
- Projektojmë dhe kryejmë procedura auditimi të përshtatshme për këto rreziqe dhe sigurojmë evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të mbështetur opinionin tonë;
- Kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin për të hartuar procedura të përshtatshme, por jo për të shprehur opinion mbi efektivitetin e tyre;
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse;
- Konkludojmë mbi përdorimin e parimit të vazhdueshmërisë nga menaxhmenti;
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisje lidhur me, ndër të tjera, planin dhe kohën e auditimit, si dhe gjetjet e rëndësishme nga auditimi, përfshirë çdo dobësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.

Besa Sahitaj Berisha-Auditore Ligjore

ECOVIS UA Kosova Sh.p.k.
Q.T.Bregu i Diellit lok.26, Prishtine
Tel.+38344124898



Datë: 26.03.2026

PASQYRA E POZITËS FINANCIARE

Me 31 dhjetor
2025Me 31 dhjetor
2024

Shënimet

Pasuria**Pasuria qarkulluese**

Paraja edhe ekuivalentët e parasë	4	140,332	94,693
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	5	6,396	3,346
Stoqet dhe mallrat	6	1,672	4,725
		148,400	102,764

Pasuria jo-qarkulluese

Prona, impiantet dhe pajisjet	7	82,971	75,368
		82,971	75,368

GJITHSEJ PASURITË

		231,371	178,132
--	--	----------------	----------------

Detyrimet qarkulluese

Huamarrjet dhe kreditë financiare		-	-
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe tjera	8	18,550	38,242
Të pagueshme tjera afatshkurta		140,472	77,976
		159,022	116,218

Detyrimet**Detyrimet jo qarkulluese**

Huamarrjet dhe kreditë financiare		-	-
Të pagueshme tjera afatgjata		-	-

Ekuiteti dhe detyrimet**Ekuiteti**

Kapitali aksionar		-	-
Fitimet / (humbjet) e mbajtura		72,349	61,914
Rezervat tjera		-	-
		72,349	61,914

GJITHSEJ EKUITETI DHE DETYRIMET

		231,371	178,132
--	--	----------------	----------------

Zn, Linda Llulla Gashi

Djetoreshë Ekzekutive

Zt, Arind Kirajtani

Mehaxher i financave



PASQYRA E TË ARDHURAVE

Për vitin që përfundoi:	Shënimet	Për vitin që	Për vitin që
		përfundon me 31 dhjetor 2025	përfundon me 31 dhjetor 2024
Të Hyrat	9	993,858	966,177
Kosto e mallit të shitur	10	(17,123)	(10,583)
Fitimi / (humbja) bruto		976,734	955,594
Të ardhurat tjera		-	-
Shpenzimet e personelit	11	(281,053)	(309,789)
Shpenzimet operative dhe administrative	12	(578,360)	(605,296)
Shpenzime tjera të përgjithshme		-	-
Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit	7	(31,682)	(27,511)
Gjithsej shpenzimet		(891,095)	(942,597)
Të ardhurat financiare		-	-
Shpenzimet financiare	13	(6,061)	-
Fitimi / (humbja) para tatimit		79,578	12,998
Shpenzimet e tatimit në fitim	14	(1,159)	(1,300)
Fitimi (humbja) neto e periudhes		78,419	11,698
Të ardhura tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse të vitit		78,419	11,698
		78,419	11,698

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezerva e rivlerësimit	Gjithsej
Me 01 JANAR 2024	-	50,216	-	50,216
Fitimi / (humbja) i/e periudhës	-	11,698	-	11,698
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-	-
Tërheqjet (dividenda)	-	-	-	-
Deponimet e kapitalit	-	-	-	-
Rregullimet e fitimeve te mbajtura	-	-	-	-
Ndarja e rezervave	-	-	-	-
Me 31 JANAR 2024	-	61,914	-	61,914
Fitimi / (humbja) i/e periudhës	-	78,419	-	78,419
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-	-
Bartje te të hyrat e shtyera	-	(67,984)	-	(67,984)
Deponimet e kapitalit	-	-	-	-
Rregullimet e fitimeve te mbajtura	-	-	-	-
Ndarja e rezervave	-	-	-	-
Me 31 DHJETOR 2025	-	72,349	-	72,349

**PASQYRA E RRJEDHES SË PARASË SË
GATSHME**

		Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024
	Shënimi		
Fitimi / (humbja) i/e vitit		78,419	11,698
<i>Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave:</i>			
Zhvlërësi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	7	31,682	27,511
Rregullimet e fitimeve të mbajtura		-	-
Dëmtimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve		-	-
Amortizimi i pasurive të paprekshme		-	-
Humbjet nga dëmtimi në pasuritë e paprekshme		-	-
Ndryshimi i vlerës së pronës investuese	7	-	-
Të ardhurat financiare		-	-
Shpenzimet financiare	15	6,061	-
(Fitimi) / humbja nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve	7	-	-
Shpenzimet e tatimit në fitim	16	1,159	1,300
		117,321	40,508
<i>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</i>			
(Rritja) / zvogëlimi në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe tjera	5	(3,048)	942
(Rritja) / zvogëlimi në stoqe	6	3,053	2,018
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera		-	-
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe tjera	9	(23,802)	(3,936)
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet tjera	9	66,605	(35,095)
Tatimi në fitim i paguar	16	(1,159)	(1,300)
Interesi i paguar	15	(6,061)	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative		152,909	3,137
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese	7	-	-
Pagesat për blerjen e pronës, pajisjeve dhe impianteve	7	(39,286)	(21,445)
Arkëtimet për shitjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	7	-	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese		(39,286)	(21,445)

Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese

Deponimet e kapitalit shtesë	1	-	-
Divdenta e paguar / Tërheqjet	1	(67,984)	-
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë	8	-	-
Ripagimi i kredive dhe huave		-	-
Pagesat e lizingut financiar		-	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese		(67,984)	-

Rritja / (zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit		45,639	(18,308)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	4	94,693	113,001
		140,332	94,693

PARAJA SIPAS BILANCIT TË GJENDJES

-	<u>140,332</u>	<u>94,693</u>
---	-----------------------	----------------------

1. Informata të përgjithshme

“DokuFest” (Organizatë Joqeveritare) me numër 5102107-0 dhe me numër fiskal 600230255 me seli në Prizren, është themeluar në bazë të Ligjit të Republikës së Kosovës për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, Nr 04/-57, sipas statutit themeltar të aprovuar nga Kuvendi i anëtarëve të shoqatës joprofitabile “DokuFest”.

DokuFest, Festivali Ndërkombëtar i Filmit Dokumentar dhe të Shkurtër, është festivali më i madh i filmit në Kosovë. Çdo vit, festivali mbush kinema dhe vende të improvizuara shfaqjesh rreth qendrës historike të Prizrenit me një përzgjedhje prej më shumë se 200 filmash të përzgjedhur nga e gjithë bota.

DokuFest u themelua në vitin 2002 me vizionin për rigjallërimin e kinemasë dhe pasurimin e jetës kulturore të Prizrenit. Gjatë viteve, DokuFest është shndërruar në festivalin kryesor të filmit dokumentar dhe të shkurtër në Evropën Juglindore. Ndërkohë, që nga viti 2019, DokuFest ka fituar statusin e nderuar si një festival kualifikues për BAFTA për filmat e shkurtër, dhe në vitin 2022, ai u caktua si një festival nominuese për Akademinë Evropiane të Filmit.

Festivali zgjat nëntë ditë emocionuese, plot ngjarje tërheqëse, përfshirë ekspozita fotografike dokumentare, debate interesante, klasa master informuese dhe performanca muzikore të gjalla. DokuFest ofron një përvojë të larmishme, duke festuar artin e kinemasë dhe duke promovuar dialogun dhe vlerësimin e arteve kinematografike në rajon.

1. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE DHE POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

2.1 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare të Organizatës janë përgatitur në bazë të modifikuar të parasë së gatshme (modified cash basis), duke përfshirë disa elemente të kontabilitetit në bazë të të drejtave dhe detyrimeve (accrual basis), sipas natyrës së transaksioneve. Bazat e matjes përshkruhen më në detaje në politikat kontabël të paraqitura më poshtë.

2.2 Monedha e paraqitjes

Monedha funksionale dhe e paraqitjes së Organizatës është euro ("EUR"). Pasqyrat financiare janë paraqitur në euro.

2.3 Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj

Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paranë në dorë dhe në bankë, si dhe llogaritë operative bankare.

2.4 Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valutë të huaj janë transaksione të realizuara në një valutë të ndryshme nga valuta funksionale e Organizatës. Këto transaksione përkthehen në euro duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat nga kursi i këmbimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

2.5 Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar, duke zbritur provizionet për humbje të mundshme. Një provizion njihet kur ekziston dëshmi objektive që Organizata nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve fillestare.

Llogaritë e arkëtueshme në valutë të huaj paraqiten në euro duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit.

Llogaritë e tjera të arkëtueshme përfshijnë parapagimet dhe aktivet e tjera rrjedhëse. Parapagimet maten me kosto dhe klasifikohen si afatgjata kur përfitimet ekonomike priten të realizohen pas më shumë se një viti.

2.6 Stoqet

Stoqet maten me koston e tyre, e cila përcaktohet sipas metodës së çmimit mesatar. Organizata i trajton stoqet si pasuri që mbahen për shitje në rrjedhën normale të aktivitetit.

Stoqet regjistrohen fillimisht me koston e tyre dhe më pas vlerësohen me vlerën neto të realizueshme nëse kjo vlerë është më e ulët se kostoja.

2.7 Pajisjet dhe makineritë

Pajisjet dhe makineritë njihen fillimisht me koston e tyre dhe më pas paraqiten me koston e amortizuar.

Një aktiv largohet nga pasqyra e pozicionit financiar kur shitet ose kur nuk pritet më përfitim ekonomik nga përdorimi i tij.

Shpenzimet për riparim dhe mirëmbajtje njihen në periudhën në të cilën ndodhin.

Amortizimi llogaritet duke përdorur metodën lineare për kategoritë e mëposhtme:

- Pajisjet e zyrës – 20%
- Pajisjet e rënda – 10%
- Objektet – 5%

2.8 Të pagueshmet tregtare

Të pagueshmet tregtare maten me vlerën e drejtë të shumës që do të paguhet për mallrat dhe shërbimet e marra, pavarësisht nëse ato janë faturuar apo jo.

2.9 Huamarrjet

Huamarrjet njihen fillimisht me vlerën e drejtë, neto nga kostot e transaksionit, dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

2.10 Detyrimet kontraktuale

Detyrimet kontraktuale përfaqësojnë detyrimin e Organizatës për të ofruar mallra ose shërbime ndaj një klienti dhe njihen kur klienti kryen pagesën paraprake ose kur Organizata fiton një të drejtë të pakushtëzuar për arkëtim.

2.11 Taksat

Organizata është themeluar si organizatë joqeveritare dhe operon në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë për OJQ-të.

2.12 Njohja e të hyrave

Të hyrat nga grantet dhe burimet e tjera njihen në periudhën në të cilën pranohen, në përputhje me bazën e parasë së gatshme.

Në fund të vitit, diferenca ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve paraqitet si tepricë ose deficit dhe bartet në periudhën pasuese.

2.13 Grantet

Grantet njihen kur ekziston siguri e arsyeshme se Organizata do të përmbushë kushtet përkatëse dhe se grantet do të pranohen.

Grantet operative njihen si të hyra në mënyrë sistematike gjatë periudhës në të cilën lidhen me shpenzimet përkatëse.

Grantet që lidhen me blerjen e pasurive afatgjata njihen fillimisht si të hyra të shtyera dhe më pas njihen si të hyra gjatë jetës së përdorimit të pasurisë përkatëse, në mënyrë sistematike dhe racionale.

2.14 Njohja e shpenzimeve

Shpenzimet njihen në periudhën në të cilën paguhen, në përputhje me bazën e parasë së gatshme.

2.15 Përfitimet e punonjësve

Organizata paguan kontribute në skemat e detyrueshme shtetërore të pensioneve në emër të punonjësve të saj. Këto kontribute njihen si shpenzim në periudhën në të cilën lind detyrimi për pagesë.

Organizata nuk operon me skema të tjera pensionale ose përfitime pas pensioni dhe nuk ka detyrime të tjera të lidhura me to.

3. PARIMI I VAZHDIMËRISË

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vazhdimësisë, i cili supozon se Organizata do të vazhdojë aktivitetin e saj në të ardhmen e parashikueshme dhe do të jetë në gjendje të realizojë aktivet dhe të shlyejë detyrimet në rrjedhën normale të aktivitetit.

4.Paraja

	Me 31 dhjetor 2025	Me 31 dhjetor 2024
Paraja në bankë	140,275	92,271
Paraja në arkë	57	2,422
Gjithsej	140,332	94,693

Me 31 dhjetor

	2025	2024
Parja në RBKO	-	-
Paraja në NLB	-	-
Paraja në TEB	-	-
Paraja në BKT	-	-
Paraja në WISE	1,980	453
Paraja në Paysera	23	66
Paraja në bankën PCB	138,272	91,752
Gjithsej	140,275	92,271

5.Llogaritë e arkëtueshme

	Me 31 dhjetor 2025	Me 31 dhjetor 2024
Të arkëtueshmet tregtare - blerësit	150	57
Sub total (I)	150	57
Parapagimet e furnitorëve	657	-
Shpenzimet e parapaguara	-	-
Të arkëtueshme tatimore (Tvsh)	3,332	904
Avanset nga punëtorët	-	-
Të arkëtueshme tjera	2,256	2,256
Parapagim furnitoreve	-	130
Sub total (II)	6,246	3,290
GJITHSEJ (I+II)	6,396	3,346

6.Stoqet

	Me 31 dhjetor 2025	Me 31 dhjetor 2024
Stoqet për shitje me pakicë	1,672	4,725
Stoqet për shitje me shumicë	-	-
Stoqet tjera - materiale	-	-
Provizion për stoqet	-	-
Gjithsej	1,671	4,725

7.Asetet	Toka	Ndertesa	Pajisjet mobileri komputere	Gjithsej
Me 31 dhjetor 2023	-	-	284,082	284,082
Blerjet gjatë vitit	-		21,445	21,445
Shitjet gjatë vitit		-	-	-
Korrigjimet e kostos		-		-
Me 31 dhjetor 2024	-		305,527	305,527
Blerjet gjatë vitit			39,286	39,286
Shitjet gjatë vitit				
Korrigjimet e kostos				
Me 31 dhjetor 2025			344,813	344,813
Zhvlërësimi				
Me 31 dhjetor 2023		-	202,648	202,648
Shpenzimi zhvlërësimi		-	27,511	27,511
Korrigjimi i zhvlërësimi për heqje		-	-	-
Me 31 dhjetor 2024		-	230,159	230,159
Shpenzimi zhvlërësimi			31,682	31,682
Korrigjimi i zhvlërësimi për heqje				
Me 31 dhjetor 2025			261,841	261,841
Vlera neto në libra				
			-	
Me 31 dhjetor 2024		-	75,368	75,368
Me 31 dhjetor 2025			82,972	82,972

	<u>Me 31 dhjetor 2025</u>	<u>Me 31 dhjetor 2024</u>
8.Llogaritë e pagueshme		
Llogarite e pagueshme tregtare	14,440	38,242
Sub total (I)	14,440	38,242
TVSH e pagueshme	67	-
Taksa e pagueshme (tatimit ne paga, qira etj)	1,172	1,736
Tatimi ne fitim I pagueshem	1,159	1,300
Kontributet e pagueshme	1,713	2,368
Obligimi per avanset e pranuar	-	85
Te hyrat e shtyra	140,472	72,488
Sub total (II)	144,582	77,976
GJITHSEJ (I+II)	159,022	116,218

9.Të hyrat

	<u>Për vitin që përfundon me 31.12.2025</u>	<u>Për vitin që përfundon me 31.12.2024</u>
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor		
Të hyrat nga shitja e produktit x Donacionet	150,794	67,318
Të hyrat tjera afariste aplikimet	843,064	861,739
Te hyrat e shtyera shfrytezim prej viti te kaluar	-	-
	-	37,120.1
Gjithsej	993,858	966,177

9.1. Të hyrat nga donacionet

Nr.	Donacionet	<u>Për vitin që përfundon me 31.12.2025</u>	<u>Për vitin që përfundon me 31.12.2024</u>
1	British Council - 2023	9,983	19,980
2	Focus Ukraine	12,615	28,284
3	Giz - Germany:GIZ - Digital Film Innovation 2024-2025	29,526	19,994
4	Princ Claus Fund:Princ Claus Fund - 2024	5,000	20,000
5	RBF - Rockefeller Brothers Fund	32,997	31,731
6	Scotish Documentary Institute 1	18,572	23,488
7	Kulturalink - Kino Kosova	13,399	-
8	Swedish International Development for Agency - SIDA 2024- 2028	269,780	175,909
9	Smart Balkans	13,525	22,289

10	Ambasada Austriake	2,990	3,022
11	Ambasada Gjermane	5,000	5,017
12	Atlantik Group Sh.P.K	4,000	3,000
13	British Council	3,961	3,014
14	G Project SHPK	15,000	10,000
15	Goethe Zentrum	3,090	-
16	IPKO Telecommunications:IPKO Telecommunications LL.C 2024	40,000	30,000
17	Komuna e Prizrenit - Projekt	48,552	-
18	UNDP	38,579	-
19	Meridian Corporation LLC	6,000	3,500
20	Ministria e Kultures Kosove ProCredit Bank SH.A.:ProCredit Bank	95,000	90,000
21	2024	105,000	70,000
22	Solar Cinema Donation	500	50
23	Uje Rugove	1,500	1,500
24	European Union Office in Kosovo The Swiss Federal Department of	15,000	-
25	Foreign Affairs - FDFA	6,000	-
26	Ambasada Irlandeze	6,977	-
27	Kontakt Collection	3,000	-
28	Ambasada Holandeze	2,500	-
29	Barut AG Dega ne Kosove	9,250	-
30	Forum Ziviler Friedendienst	3,000	-
31	Ambasada Britanike	824	-
32	Prima Tobacco LLC	10,000	-
33	Argo Group Kosova Shpk	4,000	-
34	Beldocs	7,944	-
35	Tafaj & Co SHPK	-	3,000
36	EU - How i see you Giz - Germany:GIZ - Digital Skills	-	31,108
37	Factory 2022 Amb. Holandeze - Projekti Matra KIST	-	17,137
38	Plus	-	17,577
39	NED:2022-0636	-	66,814
40	OSCE:OSCE 2024	-	20,730
41	Ambasada Franceze	-	7,262
42	Buçaj	-	15,000
43	Diarko SHPK	-	2,000
44	Goethe Institut Sarajevo	-	3,500
45	HLC Kosovo	-	6,710
46	Komuna e Prizrenit - Festival	-	70,000
47	Lumbardhi - (O.J.Q)	-	3,004
48	OSCE:OSCE - 2023 Projekt	-	9,800
49	OSCE:PO 712655	-	19,544

50	PastaFasta SHPK	-	3,000
51	Pomilio Blumm Srl	-	4,775
Totali i Donacioneve		843,064	861,739

10.Kosto e mallit të shitur

	Për vitin që përfundon me 31.12.2025	Për vitin që përfundon me 31.12.2024
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor		
Stoqet në fillim	4,725	6,742
Blerjet gjatë vitit	14,070	8,565
Stoqet në fund	1,672	4,725
Kosto e mallit të shitur	17,123	10,583

11.Shpenzimet e pagave

	Për vitin që përfundon me 31.12.2025	Për vitin që përfundon me 31.12.2024
Pagat bruto të personelit	267,669	295,076
Kontributet pensionale të personelit	13,383	14,713
Gjithsej	281,053	309,789

	Për vitin që përfundon me 31.12.2025	Për vitin që përfundon me 31.12.2024
12.Shpenzimet operative		
Shpenzimet për zyre - Komerçiale	3,764	-
Shpenzimet e higjienes - Komerçiale	-	-
Shpenzimet e sigurimit - Komerçiale	-	4,432
Shpenzimet e pastrimit te toalet kab- Komerçiale	-	-
Shpenzimet e rregullimit te DokuKino - Komerçiale	-	-
Shpenzimet e transportit te kontejnereve	-	2,250
Shpenzimet për bileta postere katalogje- Komerçiale	-	-
Shpenzimet për zerim she real.teknik- Komerçiale	23,410	11,200
Shpenzimet të skenografise-Komerçiale	-	4,770
Shpenzimet për evente-Komerçiale	3,540	-

Shpenzimet për reklame dhe marketing-Komerciale	4,130	-
Shpenzimet për perkthoim dhe titrim - Komerciale	3,600	-
Shpenzimet për kurim te festivalit-Komerciale	1,500	-
Shpenzimet për shperblime ne festival-Komerciale	9,540	-
Shpenzimet për montim të platformes - Komerciale	4,200	-
Shpenzimet për performues -Komerciale	1,740	-
Shpenzimet për material për rreg.obj. - Komerciale	1,322	-
Shpenzimet e provizionimit -Komerciale	750	-
Shpenzimet për nafte për gjenerator - Komerciale	1,300	-
Shpenzimet për ceshtje juridike -Komerciale	637	-
Shpenzimet materiale	79	324
Shpenzimet e materialit për zyre	2,629	4,832
Shpenzimet e zyres perfaqsim	3,781	950
Shpenzimet për pajimet deri 1000 Euro	9,541	12,069
Shpenzimet për skenografi	2,136	60,514
Shpenzimet e shtypjes se biletave, posterave	9,163	10,827
Shpenzimet e arkës fiskale	-	365
Shpenzime e performimit	35,000	2,079
Shpenzime e servisimit te gjeneratorit	-	4,200
Shpenzime e zerimit	12,887	34,385
Shpenzimet e auditimit	7,000	7,833
Shpenzimet e shperbl.per firma	1,000	10,500
Shpenzimet per taxi	6,088	3,765
Shpenzimet e reklames dhe marketing	5,546	6,950
Shpenzimet e perfaqsim	20,435	25,701
Shpenzimet e web dizajn	10,001	16,875
Shpenzimet për editim produksion filmor	-	5,000
Shpenzimet për publikim në gazeta	57	116
Shpenzimet për higjiene	690	2,474
Shpenzimet për sigurim	8,394	760
Shpenzimet e shfrytezimit të hapësirës	6,620	3,930
Shpenzimet e mbeturinave	134	146
Shpenzimet e regj.te veturave	266	41
Shpenzimet e sigurimit te veturave	237	53
Shpenzimet e sherb.nga jorez.5%	49,025	48,128
Shpenzimet për toalet kabina	5,508	-
Shpenzimet e renta car	300	100
Shpenzimet për hulumtim dhe ndikim ekonomik	7,950	-
Shpenzimet e internetit	1,320	1,017
Shpenzimet e ushqimit gjate trajnimit	4,465	-
Shpenzimet për online program festival focus	22	-
Shpenzimet për regj.të markes tregtare	150	120
Shpenzimet për komunikim me zoom media	213	116
Shpenzimet për dezinfektim	-	59

Shpenzimet për sherbime fotografimi	3,550	6,500
Shpenzimet për mbledhje fondesh	-	3,000
Shpenzimet për digital media workshop	-	200
Shpenzimet për bileta filmi	-	13
Shpenzimet për pajisje per perkthim	-	413
Shpenzimet për agency commision luxe	300	-
Shpenzimet për anetarsim	5,932	1,585
Shpenzimet për zhvillim të platformes	-	2,134
Shpenzimet për kartela dhe bexha	1,800	1,500
Shpenzimet për vullnetare	5,540	6,366
Shpenzimet për evente	-	6,349
Shpenzimet për booking	1,200	1,400
Shpenzimet për trajnime workshop	3,198	4,205
Shpenzimet për facebook	1,441	4,143
Shpenzimet për aplikim	202	184
Shpenzimet për aparate për zjarr	-	50
Shpenzimet për noter avokat	451	984
Shpenzimet për licence	286	1,599
Shpenzimet për prodhim video trejler	3,970	4,000
Shpenzimet për material punetori	105	-
Shpenzimet për hulumtim dhe ndikim ekonomik	-	2,759
Shpenzimet për ekspozim në panair	-	200
Shpenzimet për licence	2,059	150
Shpenzimet për kurim	2,000	-
Shpenzimet për trajnim te stafit	16	3,900
Shpenzimet për te drejta autoriale	-	6,448
Shpenzimet për te drejta autoriale ng.k.	-	28,572
Shpenzimet për prov.bankar	-	5,849
Shpenzimet për miremb.te zyres	-	551
Shpenzimet për rreg.miremb.te objektit	1,113	-
Shpenzimet për parking	781	34
Shpenzimet huazim shtepizat	200	600
Shpenzimet për bashkepunim	2,550	-
Shpenzimet për software online	522	839
Shpenzimet per mailchimp	842	197
Shpenzimet për printim dhe fotokopjim	1,049	85
Shpenzimet për screening fee	16,791	550
Shpenzimet për catering	600	-
Shpenzimet për diskutim profesional të filmave	120	-
Shpenzimet për shpalljet	83	-
Shpenzimet për dizajnim të kampanjes	5,900	-
Shpenzimet për perzgjidhje të filmave	1,736	-
Shpenzimet për denime ne komunikacion	52	-
Shpenzimet për montim cmontim te bines	13,200	-
Shpenzimet për QR code	29	-
Shpenzimet për jurine	1,084	-
Shpenzimet për huazim të pajisjeve prof.	27,686	-

Shpenzimet për sherbime profesionale	2,105	-
Shpenzimet për huazim të pajisjeve	400	-
Shpenzimet për Open AI	123	-
Shpenzimet për te drejten autoriale	5,380	-
Shpenzimet për te drejten autoriale NK	350	-
Shpenzimet për miremb.tëpajisjeve	380	-
Shpenzimet për premium plan	-	877
Shpenzimet për trajnim burime njerezore	-	249
Shpenzimet për nafte agregat	-	728
Shpenzimet për perkthim dhe titrim	17,737	19,275
Shpenzimet për miremb.të automj	1,322	1,069
Shpenzimet për udhetim zyrtar	10,702	16,811
Shpenzimet për kontabilitet	4,800	4,500
Shpenzimet për poste dhe dergesa	5	-
Shpenzimet për projekte të donacionit	3,220	7,029
Shpenzimet për subgrantet	10,651	14,000
Shpenzimet për qira	9,480	15,921
Shpenzimet për hotel	62,528	61,789
Shpenzimet për derivate	5,526	6,831
Shpenzimet për telefon	3,490	1,596
Shpenzimet për rryme	3,061	2,755
Shpenzimet për udhetim te mysafireve-biletat	42,237	40,077
Shpenzimet për transport	17,369	5,940
Shpenzimet për taksa	54	40
Shpenzimet për shpediterit	80	-
Shpenzimet për sherbime të huaja	-	215
Shpenzimet për sherb.jasht vendit ng.k.	-	338
Shpenzimet e pazbritshme	899	23,018
Gjithsej	578,360	605,296

13.Shpenzimet e interesit

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor	Për vitin që përfundon me 31.12.2025	Për vitin që përfundon me 31.12.2024
Interesi bankar - provizionet	6,061	-
Interesi - kosto e kredive financiare	-	-
Gjithsej	6,061	-

	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024
Fitimi para tatimit -	79,578	12,728
Kontributi i pronarëve - tm	-	-
Paga bruto e pronarëve	-	-
Kontributet e pronarëve	-	-
Korigjimi i shpenzimeve të pazbritshme	-	-
Baza tatimore	79,578	12,728
Tatimi në fitim		
TATIMI NË FITIM PËR VITIN	(1,159)	(1,300)

14. Kontigjencat dhe detyrimet

14.1. Çështjet ligjore

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2025 organizata nuk ka ndonjë detyrim kontigjent që kërkon shpalosje në pasqyrat financiare të saj.

15. Ngjarjet pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje domethënëse pas dates së raportimit që mund të kërkojnë rregullime ose shpalosje në pasqyrat financiare.